

(5)

PJESË NGA RREGULLORJA E REPARTEVE TË RIEDUKIMIT MBI DETYRAT E TË DREJTAT
E TË DËNUARËVE.

I. DETYRAT E TË DËNUARËVE SIPAS PARAGRAFIT 77 TË KËSAJ RREGULLORJE.

1. Kërkesat e rregullores mbi sigurimin dhe riedukimin e të dënuarëve në repartet e riedukimit e në buxhet dhe rregullat e rregjimit të brendshëm që caktohen nga komanda e repartit të riedukimit.

2. Të punojnë në prodhim e të realizojnë normën përkatëse në bazë të detyrave që jep personeli i inxhinjere-technik i ndërmarrjes e të rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajnë materialet që kanë në ngarkim personal e kolektiv për të cilat përgjigjen me qëndrimin e vlefshëm të tyre.

3. Të zbatojnë urdhërat e komandës së repartit të riedukimit dhe të personelit të shërbimit e atij mjeksor dhe atij të lirë për proceset e punës në minierë.

4. Të zbatojnë urdhërat dhe porositë e përgjegjësive të fjetoreve të grupeve, të skuadrave, të brigadjeve, të teknikëve dhe të normistëve të punës dhe të këshillit të riedukimit të të dënuarëve.

5. Të mos dhurojnë e të mos këmbëjnë sende personale me njeri - tjetrin dhe as me të lirët. Këto veprime bëhen vetëm me miratim të komandës së repartit.

II. TË DREJTAT E TË DËNUARËVE SIPAS PARAGRAFIT 78-105 TË KËSAJ RREGULLORJE

1. Të dënuarit i sigurohen falas nga shteti ushqimi, sapuni, te-
shat e veshmbathjes dhe të fjetjes në bazë të normave të miratuara nga Kë-
shilli i Ministrave.

2. Të marrin nga të afërmit e tyre çdo muaj deri në 15 kg. sende
ushqimore duke përjashtuar frutat e sarsavatet të cilat i marrin jashtë no-
rmës së caktuar.

3. Të marrin të holla nga familjet e tyre sa herë që ju dërgohen.

4. Shpenzimi i të hollave nga të dënuarit bëhet në bazë të kërke-
sës dhe të deftesës që lëshon vetë i dënuari, me të cilën blen sende ush-
qimore dhe të përdorimit vetjak, në dyqanin e hapur brenda repartit.

5. Lejohet që çdo i dënuar që disponon të holla t'ia dërgojë fa-
miljes së vet në rrugë të zakonshme, mbasi të jetë miratuar nga komanda e
repartit.

6. Të gjithë të dënuarit kanë të drejtë të takohen me familjet e
tyre dy herë në muaj nga pesëmbëdhjetë minuta, në vendin e caktuar nga ko-
manda, në prani të rojes dhe kur kjo konstaton biseda të pa lejueshme, me
një herë ndërpret takimin.

7. Të gjithë të

7. Të dënuarit të cilët dallohen për sjellje shëmbullore, për aktivizim në punë dhe japin prova riedukimi u lejohet jashtë radhës së takimit të zakonshëm, të takohen në dhoma të veçanta 1 deri 2 orë me pjesëtarët e familjes së tyre, ose të flejnë deri një natë me bashkëshorten e tyre. Këto takime nuk mbikqyren me roje brenda në dhomën e veçantë, por vetëm me rren masa sigurimi të jashtëm dhe bëhet kontrolli i intë i të dënuarëve, para dhe mbas kthimit nga takimi.

8. T'u shkruajnë familjeve të tyre brenda territorit të R.P.S.SH. 2 (dy) letra në muaj, kurse telegrame e kartolina pa kufizim. Jashtë shtetit ata mund t'u shkruajnë vetëm prindërve, bashkëshortes ose fëmijëve të tyre, kur këta nuk janë të arratisur. Letra nuk duhet të jetë më shumë se 2 (dy) faqe fletore e shkruar me dorë në gjuhën shqipe e lexueshme.

9. Të marrin prej familjeve e të afërmëve të tyre letra, kartolina e telegrame të shkruara në gjuhë shqipe.

10. T'u shkruajnë letra, telegrame, lutje K.Q.P.P.SH., Presidiumit të Kuvendit Popullor, Këshillit të Ministrave, Prokurorisë së Përgjithshme, Gjykatës së lartë, Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe organeve të Partisë, pushtetit dhe atyre të drejtësisë në rreth. Për ata që nuk kanë asnjë burim të ardhurash, shpenzimet për letra e për zarfa dhe pulla përballen nga shteti.

11. Të abonohen në organet e shtypit qëndror ose lokal brenda shtetit, të blejnë libra dhe revista (qoftë në gjuhë të huaja) që lejohen. Abonimet dhe blerëgjat e librave bëhet nëpërmjet komandës.

12. Të zhvillojnë aktivitete kulturore e artistike në bazë të programit që miraton komanda e repartit dhe lojra që kanë karakter edukativ e zbavitës, si volejbol, shah dhe domino në mënyrë të organizuar.

13. Të kurohen me shpenzimet e shtetit, të blejnë ose të marrin barnat që u vijnë nga familjet e tyre dhe t'i përdorin ato sipas recetës së mjekut ose rekomandimit të tij. Këto barna mbahen dhe ruhen në farmacinë e repartit të riedukimit dhe u japin sipas orarit dhe dozës që cakton mjeku.

14. Të dënuarëve u bëhet mjekim dentar falas dhe venia e protezave me kundërpaguesë.

15. Të dënuarëve të sëmurë u jepet ushqim i veçantë sipas raportit të mjekut të lirë konformë normave të miratuara.

16. Ata që janë paisur me raport të komisionit mjekësor u sigurohet e drejta e pushimit dhe e paafësisë së kufizuar gjatë vuajtjes së dënimit.

17. Të shohin film që çfaqen brenda rrethimit ose në vendin e caktuar nga komanda e repartit.

18. Të dënuarit që kanë qënë të fejuar para arrestimit (sipas vërtetimit që lëshon këshilli popullor i lagjes ose i fshatit të tij) gjatë vuajtjes së dënimit lidhin martes, lidhja e martesës bëhet konformë ligjes.

19. Të dënuarëve u lejohen të gatujnë ushqim personal, duke siguruar vetë lëndën djegëse, ose nga familja e tyre.

20. Të pushojnë një herë në javë dhe në festat zyrtare.

21. Të dënuarit kanë të drejtë të mbajnë me vete dy palë tesha (ndërresa të brendshme), 1 pagurë uji (alumini plasmasi), laps, fletore shkrimi, furçe e pastë dhëmbësh, një tas, një lugë gjelle alumini, dyshok, një jastek, batanije e çarçafë.

(8)

" M I R A T O H E T "

KOMISARI I REPARTIT

/ PJETER CAJA /

KOMANDANTI I REPARTIT

/ MYFTAR MYFTARI /

RREGULLORE E BRENDSHME E REPARTIT

TE DENUARIT QË VUAJNË DËNIMIN NË REPARTIN E RIETUKIMIT 303 SPAÇ SI GJATË QËNDRIMIT NË REPART DHE NË FRONTET E PUNËS, JANË TË DETYRUAR TË ZBATOJNË EDHE KËTO RREGULLA:

I. Të dënuarit në rajonin e banimit të zbatojnë edhe këto rregulla:

1. Të zbatojnë në çdo kohë orarin e veprimeve ditore të vendosur nga komanda e repartit.
2. Me thirrjen e korjerit (ose sinjalit të caktuar) të gjithë të dënuarit të mbliqhen me shpejtësi në taracë, si ditën dhe natën, dhe presin komunikimin ose urdhërat që mund të jepen nga komanda e repartit. Kur janë në punë me të marrë sinjalin, mbliqhen në vendin e caktuar dhe presin urdhërat e rojes së punës.
3. Të mbajnë pastërti në vend banimet e tyre, dhomat e fjetjes, krevatët, koridoret, banjot, teritorin rreth lokaleve të vendbanimit të tyre.
4. Të hedhin mbeturinat në vendet e caktuara për këtë qëllim.
5. Ndalohet rreptësisht mbajtja e sendeve të ndaluara siç janë: thika, sopata, sqeparë, leva, gozhdë, tela, çelsa apo mjete të tjera të ftofta.
6. Sendet apo paisjet e punës si në guzhinë, rrojtoje, rrobapësi, këpucari, të frontit të punës e të tjera punishte, janë të detyruar që t'i nxjerrin çdo mbrëmje tek oficeri i rojes në vendin e caktuar simbas inventarit dhe orarit të caktuar.
7. Ndalohet lëvizja e të dënuarëve nga një brigadë në tjetrën kur janë të rrjeshtuar dhe nga njëra dhomë në tjetrën kur pushojnë, si dhe në artizanatet pa urdhër e pa leje të rojes. Shkuarja në WC gjatë kohës së pushimit (gjumit) do të bëhet i veshur me veshje të brendshme dhe kapotë ose pallto.
8. Ndalohet ngrënja e ushqimeve në çdo vend tjetër me përjashtim të menceve të caktuara për këtë qëllim, si dhe marrja e dhënja e ushqimeve jashtë orarit të veprimeve.
9. Ndalohet kundërshtimi i urdhërave ose fyerja e personelit të shërbimit, të punonjëseve të ndërmarrjes si dhe të personelit të këshillit të riedukimit, por të zbatohen urdhërat e tyre. Për këtë qëllim çdo ankesë ose kërkesë do ta zgjidhin nëpërmjet korespondences dhe takimeve verbale me komandën e repartit.

10. Ndalohe të luajnë bixhoz ose lojra të tjera të ndaluara, të fishkëllejnë ose të përdorin njëri-tjetrin për punë personale. Kundërvajtësit do të ndiqen penalisht ose do të dënohen disiplinarisht.

11. Ndalohe argëtimi individual si me këngë ose i rënjes së veqe të ndryshme muzikore, këto do të lejohen vetëm të organizuara në bazë të programit që miraton komanda e repartit.

12. Konfliktet që mund të lindin midis njëri-tjetrit ose me personelin e lirë të ndërmarrjes punëdhënëse, do të zgjidhen nëpërmjet komandës dhe asnjë nuk ka të drejtë të krijojë grindje ose konfuzion. Shkaktarët do të ndiqen penalisht.

13. Zjarret për gatim do të ndizen vetëm në guzhinat personale sipas orarit të veprimeve me lejen e personelit të shërbimit. Nuk lejohet në asnjë mënyrë që të digjet lëndë ndërtimi e repartit ose galerie. Ndalohe përdorimi i furnellave elektrike. Shkaktarët do të ngarkohen me përgjegjësi të rëndë penale.

14. Të mos mbajnë sende personale dhe rroba të ndryshme jashtë kriterëve që përcaktohen në rregulloren e repartëve të riedukimit dhe rrobat personale t'i mbajnë të sistemuara në: tinasë në depo të veçantë me çels ose t'ua dërgojnë familjeve të tyre.

15. Teshat e lara për tharje do të vendosen vetëm në vendet e caktuara nga komanda e repartit e nuk lejohet ndërja e tyre në ballkon, në dritare apo në dhomë. Teshat që përdoren për punë do të qëndrojnë në garderobë dhe në asnjë vend tjetër.

16. Qdo i dënuar është i detyruar të marrë pjesë në punë politike në kurset e kualifikimit, në mbledhjet e analizat e ndryshme, në leximin e shtypit dhe në aktivitetet e tjera kulturore e artistike dhe sportive që organizon komanda e repartit.

11. Të dënuarit që shkojnë në punë do të zbatojnë edhe këto rregulla:

1. Vajtja dhe ardhja në frontin e punës do të bëhet në rrjesht për dy me brigadjerin e dënuar në krye. Shkëputja nga rrjeshti gjatë shkuarjes ose gjatë kthimit nga puna nuk lejohet. Shkaktarët ngarkohen me përgjegjësi disiplinore ose ligjore.

2. Të qëndrojnë në punë (front) sipas grupeve dhe vendeve të punës që është caktuar në organikë dhe detyrës së caktuar nga roja e personeli i lirë. Asnjë nuk ka të drejtë të largohet nga vendi i punës, ose të spostohet pa leje të rojes.

3. Të kryejnë detyrat për realizimin e normës së punës, që i ngarkohet nga roja e punës dhe brigadjeri i lirë dhe i dënuar dhe për pengesat

(10)

që has gjatë punës të verë në dijëni personelin e lart përmendur.

4. Të shkojnë në punë veshur me rrobat e punës dhe të mos largohen nga fronti i punës para orës së caktuar.

5. Të marrë me vete në frontin e punës jo më shumë se 250 gr. bukë, 20 gr. djeth ose marmelatë nga racioni ditor ose ushqimi personal i tyre.

6. Ndalohej kategorikisht lëvizja nga një zonë ose grup në tjetri me përjashtim të rasteve të veçanta për punë dhe vetëm me urdhër të rojes së punës.

7. Ndalohej kategorikisht ndezja e zjarrit në frontin e punës.

8. Ndalohej lëvizja dhe qëndrimi në gelaritë apo frontet e punës ku janë vendosur tabelat "Ndalim kalimi".

9. Të marrë vetëm veglat e paisjet e caktuara të tij për punë dhe të mos prekë veglat e të tjerëve pa urdhërin e brigadjerit. T'i ruaj e mirë mbajë veglat e punës, ndryshe ngarkohet me përgjegjësi materiale ose penale.

10. Ndalohej ankesat kolektive ose në rrjesht, të bërtiturit apo të thirrurit me zë të lartë dhe kënga e fishkëllima gjatë shkuarjes e ardhjes dhe qëndrimit në punë.

11. Çdo pretendim ose ankesë e paraqitur në momentin e daljes për në frontin e punës nuk merret parasysh. Kërkesat e ankesat që kanë të bëjnë me rit t'i paraqesin që kur lënë punën nëpërmjet rojes së punës.

12. Ndalohej bisedat në gjahë të huaj.

13. Ndalohej pirja e duhanit në dhomat e fjetjes dhe gjatë rreshtimit.

14. Ndalohej takimi dhe hyrja në bisedë me të dënuarit për krime kundër shtetit ose e këtyre të fundit me të dënuarit për krime të tjera.

15. Të zbatohen rregullat e sigurimit teknik në punë dhe kur ka rrezik me njëherë të njoftojnë personalin e shërbimit e sipas urdhërave që u jepen të marrin masa për parandalimin e rrezikut.

16. Ndalohej marrja me punë private gjatë orarit të punës e jashtë tij. Shkaktarët ndëshkohen disiplinarisht dhe penalisht sipas shkallës dhe dëmit që sjell fajti i kryer.

17. Ndalohej shkëmbimi i sendeve personale me të dënuarit për krime të tjera ose me ata për K.K.S.M. dhe as me personelin e lirë.

18. Të dënuarit që punojnë në artizanate, në furrë, në rrethim ose në ndërtime, të punojnë vetëm në bazë të planeve të punës të sektorit ekonomik dhe të orarit të veprimeve të miratuar nga komanda e repartit.

(11)

19. Ata që veprojnë në kundërshtim me këtë rregullore do të ndërkohen disiplinarisht me çdëntim të vlefës së materialeve dhe pelalisht.

SHEFI I SHËRBIMEVE TË REPARTIT 303 SPAÇ
/ ALEKSANDER KOLOMOVSKI /

